



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 467/3 Prot

Tiranë, më 21.04.2021

**V E N D I M**

Nr.45, datë 21.04.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 606/2, datë 12.4.2021, për mosmiratimin e kërkesës për pezullim për një afat 3 mujor të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 467 prot., datë 14.4.2021, nga nëpunësi \*\*\*\*\* , është ngritur pretendimi se, nga ana e institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, është vepruar në mënyrë të parregullt në lidhje me konstatimin e shkakut të pezullimit të marrëdhënies së tij të punës për një afat 3 mujor, duke mos e miratuar kërkesën e tij në këtë rast.

Nga hetimi administrativ i kryer dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezulton se, nëpunësi civil \*\*\*\*\* , ka kryer detyrën “Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes të Sigurisë së Aviacionit Civil”, pranë Autoritetit të Aviacionit Civil.

Nëpërmjet shkresës nr. 606 prot., datë 12.4.2021, “Kërkesë për pezullim nga shërbimi civil për një afat 3 muaj”, punonjësi në fjalë, ka kërkuar pezullimin nga shërbimi civil për një periudhë 3 muajore, për arsye trajnimi dhe arsimimi pranë Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar (SPAK), Byroja Kombëtare e Hetimit, e vërtetuar me aktin nr. 56 prot., datë 6.4.2021, të këtij organi.

Veprimet e mësipërme të kërkuesit janë kryer në zbatim të nenit 55, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe pikës 10, gërma “b”, Kreu I, “Pezullimi”, e Vendimit nr.124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, ku përcaktohet se, nëpunësi civil, me kërkesën e tij, mund të kërkojë pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil për periudha studimi nga 1 muaj deri në 2 vjet, vërtetuar me dokumentin përkatës të ndjekjes së studimeve.

Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, pas shqyrtimit, me aktin nr. 606/2, datë 12.4.2021, ka vendosur mosmiratimin e kërkesës së nëpunësit \*\*\*\*\*, për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil për 3 muaj, duke arsyetuar se, pezullimi në këtë moment ndikon në mbarëvajtjen e punës, si dhe pengon përmbushjen e detyrave të përcaktuara me afat, për shkaqe të tilla si, së pari, përfshirja në grupin e punës (kryetar grupi) në procesin e çertifikimit të Aeroportit të Kukësit; së dyti, mungesa e stafit të drejtorisë (Përgjegjësja e Sektorit është me leje lindje), në kushtet kur, sipas pikës 2, të nenit 56, të ligjit, pozicioni i punës nuk mund të plotësohet deri në përfundimin e pezullimit dhe, së treti, kërkesa për pezullim nuk i është përmbajtur afateve të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore.

Nga përmbajtja e shkresës si më sipër, duke patur parasysh përcaktimet e pikës 3, të Kreut I, të Vendimit nr.124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, ku thuhet shprehimisht se, *pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkaqet e parashikuara në nenin 54, të ligjit për nëpunësin civil, bëhet me konstatimin e shkakut të ligjshëm të pezullimit nga njësia e burimeve njerëzore*, rezulton se, në rastin konkret, njësia e burimeve njerëzore, në asnjë moment, nuk është shprehur për ligjshmërinë e shkakut të kërkesës për pezullim.

Sipas përcaktimeve të pikës 4, gërma “a”, të nenit 55, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, vetëm konstaton ligjshmërinë e shkakut të pezullimit, pasi, jemi në kushtet e konstatimit të pezullimit sipas pikës 1, të nenit 55, të ligjit dhe jo të miratimit të tij, siç ka vepruar në rastin konkret njësia e burimeve njerëzore të institucionit.

Në këto rrethana, vlerësohet se jemi para një akti të paligjshëm të njësisë së burimeve njerëzore, pasi nuk është shprehur në lidhje me konstatimin e ligjshmërisë së shkakut të

pezullimit, por është shprehur në lidhje me mosmiratimin e kërkesës për pezullim, duke e lidhur këtë qëndrim me detyrimet e nëpunësit dhe duke lënë mënjane të drejtën e tij për arsimim të mëtejshëm në kushtet e një shkaku të ligjshëm e të qenësishëm, siç është trajnimi pranë një organi si Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Byroja Kombëtare e Hetimit.

Në përfundim, nga gjithë sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në konkluzionin se, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, organi publik, i cili ka nxjerrë aktin e mësipërm, bazuar në nenin 109, 113 dhe 114/1, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të konstatojë paligjshmërinë e tij, duke nxjerrë aktin e konstatimit të ligjshmërisë së shkakut të pezullimit, siç u përmend në pjesën e sipërme arsyetuese të këtij vendimi.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga organi publik, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil, që pasi të konstatojë paligjshmërinë e aktit nr. 606/2, datë 12.4.2021, “Kthim përgjigje ndaj kërkesës për pezullim 3 mujor, shkresa nr.606, datë 12.4.2021”, ta anulojë atë dhe pas kësaj të nxjerrë aktin përkatës, duke konstatuar si të ligjshëm shkakun e pezullimit për një afat 3 mujor për nëpunësin \*\*\*\*\*.
2. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **5** ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia e burimeve njerëzore të institucionit është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e përcaktuara në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”,

të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

5. Të njoftohen për këtë vendim, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Byroja Kombëtare e Hetimit, si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**